VENDIM
Nr. 494, datë 26.6.2026

PËR DEKLARIMIN PASURI KULTURORE E PALUAJTSHME TË "QENDRËS HISTORIKE" TË FSHATIT DHËRMI, PËRCAKTIMIN E ZONËS MBROJTËSE DHE MIRATIMIN E PLANIT PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave "a" dhe "ç", të pikës 3, të nenit 9, të pikës 3, të nenit 62, dhe të pikës 1, të nenit 96, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Deklarimin pasuri kulturore e paluajtshme të "Qendrës historike" të fshatit Dhërmi dhe përcaktimin e zonës mbrojtëse të saj, sipas hartave të zonifikimit dhe koordinatave në Kornizën Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.
2. Miratimin e planit për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e "Qendrës historike" të fshatit Dhërmi dhe zonës mbrojtëse të saj, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Vendimi nr. 29, datë 20.1.2016, i Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen e 'Qendrës historike'" të fshatit Dhërmi dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj e të zonës së mbrojtur përreth", shfuqizohet.
4. Ngarkohet Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor për publikimin e hartave të "Qendrës historike" të fshatit Dhërmi dhe zonës mbrojtëse të saj në Gjeoportalin Kombëtar.
5. Ngarkohet Agjencia Shtetërore e Kadastrës për regjistrimin e këtij vendimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kadastrën.
6. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Himarë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

PLANI PËR RUAJTJEN, MBROJTJEN DHE ADMINISTRIMIN E "QENDRËS HISTORIKE" TË FSHATIT DHËRMI DHE TË ZONËS MBROJTËSE TË SAJ

Neni 1
Qëllimi

Ky plan përcakton rregullat, procedurat, autoritetet shtetërore përgjegjëse për ruajtjen, mbrojtjen dhe administrimin e "Qendrës historike" dhe të zonës mbrojtëse të fshatit Dhërmi, si dhe kufijtë e tyre.

Neni 2
Objekti

Objekti i këtij plani është:
1. Administrimi i "Qendrës historike" të fshatit Dhërmi dhe të zonës mbrojtëse të saj, sipas hartës së zonifikimit, që i bashkëlidhet këtij plani, si pjesë përbërëse e tij.

2. Mbrojtja, konservimi dhe restaurimi i vlerave arkitektoniko-kulturore dhe vlerave të peizazhit të “Qendrës historike” të fshatit Dhërmi dhe të zonës mbrojtëse të saj.

3. Përcaktimi i mënyrave të bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore për ruajtjen, administrimin, mbrojtjen dhe restaurimin e vlerave të trashëgimisë kulturore e të peizazhit të “Qendrës historike” të fshatit Dhërmi dhe të zonës mbrojtëse të saj.

Neni 3

Hapësira urbane në mbrojtje

1. Hapësira urbane në mbrojtje të fshatit Dhërmi përbëhet nga:

a) qendra historike;

b) zona mbrojtëse.

2. Brenda këtyre zonave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, përfshihen pasuri kulturore, objekte shoqërore, banesa tradicionale të lidhura ngushtë me peizazhin urbanistiko-arkitektonik, zona të gjelbra, sheshe dhe rrjeti rrugor me prezencë kalldrëmi.

3. Plani i përgjithshëm vendor i Bashkisë Himarë merr parasysh kufijtë dhe kriteret e mbrojtjes së “Qendrës historike” dhe të zonës mbrojtëse të saj.

4. Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e “Qendrës historike” dhe të zonës mbrojtëse përreth saj.

Neni 4

“Qendra historike” dhe kufijtë e saj

1. “Qendra historike” e fshatit Dhërmi është hapësira urbane me vlera të rëndësishme urbanistiko-arkitekturore, që dokumenton rrugën e zhvillimit arkitektonik të fshatit Dhërmi dhe arritjet në arkitekturë dhe në urbanistikë. Ajo ruan gjini të ndryshme ndërtimore si, ndërtime shoqërore, kulti dhe banesa popullore. Këto ndërtime janë të lidhura me peizazhin urbanistiko-arkitektonik, historik dhe tradicional, brenda të cilit ruhen edhe zona të gjelbra.

2. “Qendra historike” e fshatit Dhërmi përbëhet nga dy zona:

a) Zona I, e cila përfshin ndërtimet në të dyja krahët e rrugës nacionale në hyrje të fshatit Dhërmi;

b) Zona II, e cila përfshin pjesën e Dhërmiut të vjetër dhe shtrihet në pjesën verilindore deri mbi Rrënojat e Manastirit të Panaisë me Kishën e Fjetjes së Shën Mërisë dhe në jugperëndim zbret deri poshtë rrugës nacionale.

3. Kufijtë e “Qendrës historike” paraqiten në hartën e zonifikimit të fshatit Dhërmi, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani.

4. Koordinatat në sistemin referues zyrtar KRGJSH paraqiten në anekset 1 dhe 2, që janë pjesë përbërëse të këtij plani.

Neni 5

Zona mbrojtëse e “Qendrës historike” dhe kufijtë e saj

1. Zona mbrojtëse shtrihet në pjesën më të madhe në anën juglindore të “Qendrës historike”. Ajo përbëhet nga:

a) nënzona I mbrojtëse;

b) nënzona II mbrojtëse (zonë e gjelbër).

2. Nënzona I mbrojtëse përmban banesa me vlera arkitektonike dhe rrjetin rrugor karakteristik të fshatit, me të cilat plotësohen vlerat e “Qendrës historike” dhe krijon një kalim të butë prej saj drejt pjesëve të planifikuara për ndërtime të reja.

3. Nënzona II mbrojtëse është një zonë me një gjelbërim, që formohet nga drurë të ndryshëm, si ullinj, rrepe dhe bimësi të ndryshme që ndan edhe dy pjesët e "Qendrës historike" dhe përbën pjesën më të madhe të zonës së gjelbër të fshatit.

4. Kufijtë e zonës mbrojtëse paraqiten në hartën e zonifikimit të fshatit Dhërmi, e cila është pjesë përbërëse e këtij plani.

5. Koordinatat në sistemin referues zyrtar KRGJSH paraqiten në anekset 3 dhe 4, që janë pjesë përbërëse të këtij plani.

Neni 6

Ndërhyrjet e lejuara në "Qendrën historike"

1. Ndërhyrjet restauruese dhe rijetëzuese në "Qendrën historike" kanë si qëllim kthimin e fshatit Dhërmi në një qendër të rëndësishme turistike, të karakterit rural dhe familjar. Për të realizuar këtë qëllim, për "Qendrën historike" kryhen studime për mënyrën e ndërhyrjeve restauruese dhe rijetëzuese në ndërtimet që e përbëjnë, si dhe për rehabilitimin e zonave të veçanta të saj.

2. Me qëllim ruajtjen e vlerave urbanistiko-arkitektonike të "Qendrës historike" të fshatit Dhërmi, brenda kësaj zone lejohen vetëm këto ndërhyrje:

a) Sistematike mirëmbajtëse, konservuese, restauruese dhe rijetëzuese, sipas parimeve të konservimit të integruar;

b) Restauruese, që synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistiko-arkitektonike, rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit të hapësirave pushuese dhe të bimësisë tradicionale;

c) Të rikonstruksionit dhe të rindërtimit të ndërtesave mbi strukturat ekzistuese që duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të qendrës historike, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve tradicionale, si trajtimi i tyre me materiale të traditës, duke mos tejkaluar lartësinë maksimale të objekteve të vëna në mbrojtje;

ç) Rehabilituese, konservuese dhe rikonstruksion/rindërtim, për strukturat që janë në gjendje rrënoje, të cilat mund të kryhen në të njëjtin vëllim mbi strukturën ekzistuese (mureve perimetralë), bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik, mbështetur në tipologjinë, trajtimin arkitektonik dhe teknikën tradicionale të ndërtimit;

d) Rikonstruksion/rindërtim mbi strukturat ekzistuese, në rastet e fatkeqësive natyrore, të shembjeve ose djegies së objekteve me vlera të trashëgimisë kulturore, të cilat mund të kryhen mbi strukturat ekzistuese, sipas formulimit kompozicional dhe arkitektonik të gjendjes para rrënimit, bazuar në dokumentacionin e qartë fotografik, grafik etj.;

dh) Rehabilitim dhe ritrajtim, në rastet e objekteve ekzistuese me ndërhyrje jo në harmoni me zonën, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtesave tradicionale.

Neni 7

Ndërhyrjet e lejuara në zonën mbrojtëse të "Qendrës historike"

1. Ndërhyrjet e lejuara në nënzonën I mbrojtëse janë:

a) ndërhyrje sistematike të mirëmbajtjes, konservuese dhe restauruese;

b) përshtatje, rikonstruksione, rindërtime apo ndërtime të reja, në përputhje me parimet e konservimit të integruar dhe mbrojtjes së peizazhit kulturor, sipas parashikimeve të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar, për të rritur vlerat brenda saj dhe përmirësimin e infrastrukturave, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të zonës dhe në respekt me kriteret e këtij plani;

c) rijetëzime, me kusht që projekti të mos dëmtojë vlerën e pasurisë kulturore, sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar;

ç) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar;

d) rikonstruksioni i rrjetit rrugor dhe i shesheve për përmirësimin e kushteve të infrastrukturës apo realizimin e linjave të reja të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore, duke përdorur materiale, forma dhe teknika tradicionale. Në rastet kur gjurma e rrugës në të cilën ndërhyhet, shtrohet në disa zona, ndërhyrja u nënshtrohet kritereve të zonës me mbrojtje më të lartë;

dh) ndërhyrje të mobilimit urban, me vendosje mbi rrugë të stolave, ndriçuesve, koshave, vazove me lule ose elementeve të tjera të mobilimit urban, me kusht që të jenë pjesë e një projekti rikualifikimi të zonës, që parashikon vendosjen e elementeve, në harmoni me tipologjinë dhe vlerat tradicionale;

e) ruajtja dhe përfshirja e vlerave mjedisore, duke mbajtur të pandryshuar konfiguracionin e truallit dhe llojshmërinë e drurëve e të bimësisë tradicionale.

2. Ndërhyrjet e lejuara në nënzonën II mbrojtëse janë:

a) rehabilitimi i sipërfaqeve të gjelbëruara ekzistuese, si dhe mbjellja e pemëve tradicionale;

b) sistemuese, rregulluese dhe realizimi i rrugicave të brendshme këmbësore me teknika tradicionale;

c) të arredimit urban ose struktura të përkohshme e të çmontueshme shërbimi.

3. Në nënzonën II mbrojtëse ndalohen ndërtimet e reja dhe tjetërsimi i konfiguracionit natyral të truallit.

Neni 8

Ndërhyrjet e lejuara në monumentet e kulturës

1. Ndërhyrjet në monumentet e kulturës të kategorive I dhe II, të cilat ndodhen brenda "Qendrës historike" të fshatit Dhërmi, kanë për qëllim ruajtjen dhe mbrojtjen e vlerave, për të cilën janë shpallur pasuri kulturore.

2. Ndërhyrjet e lejuara janë:

a) sistematike të mirëmbajtjes, konservuese, restauruese;

b) rrjetëzime, me kusht që projekti i rijetëzimit të mos cenojë vlerën e pasurisë kulturore, sipas ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar;

c) vendosja e strukturave të përkohshme, fiksimi i flamujve, vendosja e materialeve informuese dhe reklamuese, sipas nenit 101, të ligjit nr. 27/2018, "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë", të ndryshuar.

Neni 9

Ndërhyrjet e ndaluara në tërësinë e "Qendrës historike" dhe të zonës mbrojtëse të saj

1. Në hapësirën e "Qendrën historike" nuk lejohen:

a) ndërtimet e reja, me përjashtim të rikonstruksionit të rrjetit inxhinierik nëntokësor dhe ndërhyrjeve të lejuara në nenin 6, të këtij plani;

b) instalime që paraqesin rreziqe ose janë të një natyre të rrezikshme, që mund t'u shkaktojnë dëme të rënda ose të pandreqshme njerëzve, pasurive, natyrës dhe peizazhit, terreneve sportive mbi 220 m^2, strukturave industriale dhe gurore.

2. Në hapësirën e zonës mbrojtëse të "Qendrës historike" nuk lejohen:

a) struktura industriale;

b) guroret.

Neni 10

Kriteret e projektimit për ndërhyrjet e lejuara në "Qendrën historike",

dhe në zonën mbrojtëse të saj

1. Studimet arkitektoniko-urbanistike për zona të veçanta të "Qendrës historike" dhe të zonës mbrojtëse të saj përcaktojnë objektet ku kryhen ndërhyrje konservuese e restauruese, objektet ku kryhen ritrajtime për të rritur vlerat e tyre, objektet në gjendje rrënoje ose të papërshtatshme për funksionim dhe që cenojnë unitetin arkitekturor të ansamblit ose zonës, ku lejohen të kryhen rikonstruksione apo ndërhyrje integruese, bazuar në karakteristikat e ndërtimeve tradicionale, si dhe parcelat e gjelbëruara.

2. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin, restaurimin dhe rijetëzimin e objekteve ekzistuese në "Qendrën historike" dhe të zonës mbrojtëse të saj (nënzona I), hartohen në varësi të vlerave arkitektonike-kulturore të objektit, si dhe të kritereve për konservim dhe restaurim, bazuar në kartat ndërkombëtare për restaurim, legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

3. Projektet për rikonstruksionet/rindërtimin mbi strukturat ekzistuese, rehabilitimin, brenda "Qendrës historike", hartohen:

a) duke ruajtur karakteristikat tradicionale të ndërtesave të zonës, elementet origjinale të dukshme, të jashtme e të brendshme, tipologjinë dhe teknikën tradicionale;

b) duke respektuar sa më shumë trajtimin origjinal të pamjeve të jashtme dhe elemente të veçanta me vlerë për trashëgiminë kulturore;

c) duke respektuar volumetrinë dhe lartësinë origjinale të strukturës;

ç) duke përcaktuar materialin, madhësinë, ngjyrën e dyerve dhe dritareve, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës;

d) duke ruajtur origjinalitetin e ndërtimit të çative 4-ujëse (katërujëse), me pjerrësi 25–30 gradë, mbuluar me tjegulla vendi ngjyrë të kuqe, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës.

4. Projektet për rikonstruksionin e objekteve mbi strukturat ekzistuese dhe ndërtimet e reja në nënzonën I mbrojtëse të "Qendrës historike" hartohen, bazuar në planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Himarë apo në studime urbanistike e arkitektonike, duke respektuar kriteret e mëposhtme:

a) Lartësia maksimale ose numri i kateve duhet të jetë i njëjtë me mesataren e kateve të ndërtesave përreth, por sidoqoftë jo më shumë se 2–6,5 m deri në kornizën e çatisë, lartësi maksimale e marrë në pjesën me pjerrësi më të madhe të terrenit;

b) Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.;

c) Përcaktimi i materialit, madhësisë, ngjyrës së dyerve e të dritareve, të jetë në harmoni me peizazhin kulturor të zonës;

ç) Ruajtja e origjinalitetit të ndërtimit të çative katërujëse, me pjerrësi 25–30 gradë, mbuluar me tjegulla vendi ngjyrë të kuqe, në harmoni me peizazhin kulturor të zonës.

5. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore brenda "Qendrës historike" dhe zonës mbrojtëse hartohen:

a) bazuar në parashikimet e planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Himarë;

b) duke mos cenuar vlerat e objekteve ekzistuese në mbrojtje;

c) duke mos krijuar kontrast me kompozimin urban dhe arkitektonik;

ç) duke respektuar kriteret e neneve 6 dhe 7, të këtij plani.

6. Projektet për rehabilitimin e sipërfaqeve të gjelbëruara ekzistuese në nënzonën II mbrojtëse të "Qendrës historike" hartohen:

a) duke ruajtur të pandryshuar konfiguracionin e terrenit;

b) duke respektuar kushtin që janë për përdorim vetëm këmbësor.

Neni 11

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve në "Qendrën historike" dhe në zonën mbrojtëse të saj

1. Studimet arkitektoniko-urbanistike, të cilat hartohen për rehabilitimin e pjesëve të veçanta të "Qendrës historike" apo të zonës mbrojtëse të saj dhe të cilat përcaktojnë objektet ku kryhen ndërhyrje konservuese e restauruese, rikonstruksione apo rindërtime, hartohen nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (në vijim "IKTK"), Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore (në vijim "DRTK') përgjegjëse për fshatin Dhërmi ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Studimet shqyrtohen dhe miratohen në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale (në vijim "KKTKM").

2. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin dhe restaurimin në "Qendrës historike" hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja përgjegjëse për fshatin Dhërmi ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse ose subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

3. Projektet për rijetëzimim, rehabilitimin, rikonstruksionin dhe rindërtimin e objekteve në gjurmët ekzistuese, brenda "Qendrës historike", hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja përgjegjëse për fshatin Dhërmi ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse ose subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

4. Projektet për mirëmbajtjen, konservimin, restaurimin, rikonstruksionet dhe ndërtimet e reja në nënzonën I mbrojtëse të "Qendrës historike" hartohen nga persona të licencuar për këtë kategori projektesh, bazuar në planin e përgjithshëm vendor të Bashkisë Himarë apo studimeve urbanistike e arkitektonike. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas legjislacionit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga subjekte të licencuara në këtë kategori. Mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet nga subjekte të licencuara në këtë kategori dhe monitorohet nga DRTK-ja përgjegjëse për fshatin Dhërmi.

5. Projektet për restaurimin e shesheve dhe rrjetit rrugor dhe rikonstruksionin e linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore në "Qendrën historike" hartohen nga IKTK-ja, DRTK-ja përgjegjëse për fshatin Dhërmi ose/dhe nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Projektet shqyrtohen dhe miratohen në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve kryhet nga DRTK-ja përgjegjëse ose subjekte të licencuara për zbatim të veprimtarive ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi kryhen sipas legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

6. Projektet për rikonstruksionin dhe ndërtimet e reja të rrjetit rrugor, shesheve dhe linjave të infrastrukturës mbi dhe nëntokësore në nënzonën I mbrojtëse hartohen nga persona të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Projektet shqyrtohen e miratohen edhe në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhet sipas ligjit për planifikimit dhe zhvillimit të territorit. DRTK-ja përgjegjëse për fshatin Dhërmi monitoron procesin e zbatimit të punimeve.

7. Projektet për rehabilitimin e sipërfaqeve të gjelbëruara ekzistuese si dhe mbjellja e pemëve, punimet sistemuese, rregulluese dhe realizimet e rrugicave të brendshme në nënzonat I dhe II mbrojtëse të "Qendrës historike" hartohen nga persona të licencuar, sipas legjislacionit

në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Projektet shqyrtohen e miratohen edhe në KKTKM. Procedura e miratimit vijon sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. Zbatimi i punimeve, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhen sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. DRTK-ja përgjegjëse për fshatin Dhërmi monitoron procesin e zbatimit të punimeve.

8. Projektet për vendosjen e strukturave të përkohshme, fiksimin e flamujve, vendosjen e materialeve informuese dhe reklamuese në "Qendrën historike" dhe në zonën mbrojtëse hartohen nga persona fizikë apo juridikë, të licencuar për projektim. Projektet shqyrtohen dhe miratohen edhe në KKTKM. Procedura më pas vijon me urdhër të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Zbatimi i punimeve, mbikëqyrja dhe kolaudimi kryhen sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit. DRTK-ja përgjegjëse për fshatin Dhërmi monitoron procesin e zbatimit të punimeve.

NËNZONA MBROJTËSE I E QENDRËS HISTORIKE DHËRMI

Nr.	X	Y
54	469311.6539	4446314.142
55	469342.8701	4446335.599
56	469407.1546	4446392.573
57	469421.5808	4446460.464
58	469455.4045	4446444.185
59	469555.4133	4446426.932
60	469571.6916	4446464.558
61	469578.3199	4446547.898
62	469595.3779	4446559.205
63	469610.7789	4446609.015
64	469566.8179	4446642.254
65	469519.3478	4446651.319
66	469492.0549	4446706.392
67	469450.9207	4446762.927
68	469409.1041	4446786.419
69	469350.2295	4446811.469
70	469269.3256	4446785.931
71	469266.7913	4446796.361
72	469266.9862	4446805.913
73	469267.3761	4446820.34
74	469272.3473	4446839.055
75	469274.5892	4446843.051
76	469281.8024	4446857.38
77	469281.0226	4446869.174
78	469277.611	4446874.146
79	469270.7877	4446878.629
80	469258.7009	4446876.29
81	469251.7802	4446872.878
82	469230.6282	4446851.434
83	469218.5414	4446834.668
84	469208.2091	4446820.242
85	469191.8334	4446809.91
86	469179.3566	4446802.697
87	469154.7931	4446826.675

88	469102.7417	4446817.123
89	469009.3611	4446777.158
90	469008.7762	4446742.847
91	468958.8693	4446697.229
92	468973.2955	4446680.074
93	468970.5662	4446647.127
94	468961.0137	4446616.52
95	468963.1581	4446572.072
96	468942.6885	4446521.775
97	468975.245	4446489.609
98	469004.0974	4446499.161
99	468996.8843	4446489.609
100	468976.8046	4446474.598
101	468932.1612	4446493.313
102	468899.0199	4446526.649
103	468915.9805	4446552.187
104	468926.1178	4446602.679
105	468925.338	4446652.391
106	468917.1502	4446690.601
107	468952.4359	4446701.323
108	468983.2379	4446740.703
109	468986.552	4446754.739
110	468982.848	4446777.158
111	469000.7833	4446784.566
112	469033.5347	4446811.859
113	469082.8569	4446838.957
114	469150.6991	4446872.099
115	469253.0474	4446917.327
116	469329.8573	4446901.146
117	469391.8511	4446810.3
118	469445.657	4446786.321
119	469493.8094	4446736.414
120	469531.8245	4446672.471
121	469568.28	4446656.875
122	469623.6455	4446613.791
123	469635.5374	4446557.256
124	469635.7324	4446499.941
125	469737.6907	4446468.164
126	469787.4027	4446479.471
127	469798.1249	4446449.839
128	469817.035	4446442.626
129	469800.6592	4446403.636
130	469790.9118	4446367.376
131	469764.0088	4446305.772
132	469774.1462	4446261.908
133	469780.5795	4446187.827
134	469804.9481	4446156.441
135	469753.774	4446061.89
136	469633.198	4445928.448
137	469602.3961	4445940.924
138	469495.564	4445857.681
139	469375.6703	4445765.665
140	469279.3655	4445813.623

141	469173.7031	4445903.104
142	469183.4506	4445907.978
143	469189.1041	4445916.361
144	469207.8192	4445897.256
145	469239.3522	4445930.397
146	469265.8653	4445901.545
147	469265.3779	4445920.893
148	469270.4466	4445913.827
149	469272.591	4445899.888
150	469273.7607	4445897.987
151	469279.2193	4445896.086
152	469288.5281	4445895.94
153	469302.1258	4445898.816
154	469305.8298	4445898.474
155	469309.4851	4445894.478
156	469312.5068	4445910.902
157	469314.3589	4445922.599
158	469312.6043	4445931.469
159	469314.0664	4445936.636
160	469320.6947	4445942.192
161	469330.2472	4445953.499
162	469323.0341	4445969.192
163	469300.5175	4446010.131
164	469300.7124	4446018.904
165	469299.3478	4446024.655
166	469299.5427	4446030.796
167	469303.5392	4446034.5
168	469302.6619	4446057.114
169	469296.8134	4446069.688
170	469297.4958	4446089.086
171	469294.7665	4446110.14
172	469292.7195	4446114.234
173	469293.0119	4446119.498
174	469294.9614	4446123.689
175	469298.6655	4446131.975
176	469295.6437	4446152.444
177	469293.0119	4446157.708
178	469292.9145	4446182.174
179	469290.4776	4446189.874
180	469283.362	4446201.864
181	469280.0478	4446206.543
182	469277.0261	4446211.319
183	469298.568	4446232.081
184	469307.6331	4446235.493
185	469317.5755	4446237.832
186	469325.3735	4446238.417
187	469327.4204	4446243.29
188	469349.2547	4446248.749
189	469344.9659	4446251.088
190	469339.8972	4446251.673
191	469330.3447	4446261.226
192	469327.2255	4446261.421
193	469324.1063	4446272.435

194	469340.9694	4446281.403
195	469328.9557	4446307.063
196	469311.6539	4446314.142

KOORDINATAT E NËNZONËS II MBROJTËSE
(ZONËS SË GJELBËR) DHËRMI

Nr.	**X**	**Y**
197	469311.7514	4446314.081
198	469328.9069	4446307.063
199	469340.9938	4446281.33
200	469324.2281	4446272.362
201	469327.3473	4446261.445
202	469330.4665	4446261.25
203	469339.8241	4446251.698
204	469344.8927	4446251.113
205	469349.1816	4446248.773
206	469327.3473	4446243.315
207	469325.3978	4446238.441
208	469317.5999	4446237.856
209	469307.8524	4446235.517
210	469298.6898	4446232.008
211	469277.0505	4446211.343
212	469279.9747	4446206.664
213	469283.4838	4446201.986
214	469290.307	4446189.899
215	469292.8413	4446182.491
216	469293.2312	4446157.927
217	469295.7656	4446152.469
218	469298.8848	4446142.916
219	469298.6898	4446131.999
220	469294.9858	4446124.006
221	469292.8413	4446119.717
222	469292.8413	4446114.259
223	469294.7908	4446110.36
224	469297.5201	4446089.11
225	469296.7403	4446069.81
226	469302.7838	4446057.138
227	469303.3686	4446034.524
228	469299.6646	4446030.82
229	469299.2747	4446024.777
230	469300.6393	4446018.928
231	469300.6393	4446010.156
232	469323.0585	4445969.216
233	469330.0766	4445953.621
234	469320.7191	4445942.314
235	469314.0908	4445936.66
236	469312.5312	4445931.591
237	469314.2857	4445922.624
238	469312.5312	4445910.927
239	469309.412	4445894.551
240	469305.9029	4445898.45
241	469302.1989	4445898.84
242	469288.5525	4445895.916

243	469279.1949	4445896.111
244	469273.7363	4445898.06
245	469272.5666	4445900.01
246	469270.4222	4445913.851
247	469265.3535	4445920.869
248	469265.9384	4445901.569
249	469239.4253	4445930.422
250	469207.5511	4445897.378
251	469189.2259	4445916.288
252	469183.1825	4445908.1
253	469173.2401	4445903.226
254	469179.9171	4445917.116
255	469169.2437	4445955.521
256	469234.3566	4446048.317
257	469223.8294	4446066.642
258	469168.7563	4446061.379
259	469134.5427	4446108.166
260	469129.2791	4446180.493
261	469131.6185	4446252.429
262	469109.9791	4446303.31
263	469080.9317	4446359.846
264	469086.3903	4446416.381
265	469105.1054	4446467.847
266	469088.3398	4446490.267
267	468997.2986	4446489.682
268	469004.3168	4446499.039
269	469033.949	4446527.307
270	469055.9783	4446562.008
271	469090.8741	4446594.174
272	469100.8165	4446613.084
273	469132.7882	4446613.474
274	469167.6841	4446656.948
275	469196.9264	4446696.913
276	469196.1466	4446737.072
277	469179.381	4446761.246
278	469178.4063	4446802.77
279	469191.6628	4446810.178
280	469208.2335	4446820.12
281	469218.5658	4446834.742
282	469230.4577	4446851.312
283	469251.9021	4446872.757
284	469258.9202	4446876.461
285	469270.6172	4446878.41
286	469277.6353	4446873.926
287	469281.1444	4446869.247
288	469281.7293	4446857.551
289	469274.7111	4446843.319
290	469272.1768	4446839.03
291	469267.303	4446820.12
292	469266.9131	4446806.084
293	469266.9131	4446796.531
294	469269.4475	4446786.004
295	469295.3757	4446740.776

296	469289.7222	4446707.44
297	469291.6717	4446668.45
298	469308.4373	4446649.93
299	469294.4009	4446614.839
300	469267.2056	4446614.839
301	469240.595	4446594.954
302	469216.1289	4446558.206
303	469190.7855	4446515.123
304	469149.8462	4446481.396
305	469137.7594	4446442.407
306	469135.6149	4446401.662
307	469172.0704	4446366.961
308	469212.2299	4446341.033
309	469311.7514	4446314.081

QENDRA HISTORIKE E FSHATIT DHËRMI
QENDËR HISTORIKE 1

	E	**N**
1	468942.5297	4446521.729
2	468963.0914	4446572.23
3	468960.6688	4446616.347
4	468970.7355	4446647.15
5	468973.2363	4446679.835
6	468958.8713	4446697.475
7	469008.7593	4446742.921
8	469009.1362	4446777.156
9	469102.5489	4446817.181
10	469154.4195	4446826.839
11	469178.7008	4446803.299
12	469179.2401	4446761.348
13	469196.4178	4446736.911
14	469196.2559	4446697.123
15	469167.4566	4446657.451
16	469132.487	4446613.794
17	469100.2955	4446613
18	469091.4617	4446594.221
19	469055.5901	4446561.673
20	469033.9112	4446527.215
21	469003.9737	4446498.961
22	468975.2977	4446489.825

QENDRA HISTORIKE E FSHATIT DHËRMI
QENDËR HISTORIKE 2

	E	**N**
23	469269.514	4446786.274
24	469350.0852	4446811.548
25	469409.1514	4446786.325
26	469450.9485	4446763.023
27	469492.1382	4446706.412
28	469519.3711	4446651.399
29	469566.6698	4446642.264

30	469610.5587	4446609.084
31	469595.212	4446559.486
32	469578.3622	4446548.141
33	469571.6359	4446464.58
34	469555.3904	4446427.015
35	469455.3418	4446444.074
36	469421.5626	4446460.558
37	469407.0864	4446392.451
38	469342.9513	4446335.648
39	469311.6216	4446314.184
40	469212.3235	4446341.422
41	469171.7194	4446367.496
42	469135.6454	4446401.572
43	469137.706	4446442.586
44	469149.6984	4446481.401
45	469190.5465	4446515.472
46	469216.282	4446558.241
47	469240.5734	4446595.156
48	469266.9245	4446614.789
49	469294.6179	4446615.294
50	469309.1951	4446649.78
51	469291.9955	4446668.974
52	469290.0231	4446707.846
53	469295.365	4446741.136

QENDRA HISTORIKE DHËRMI





NR.	E	N
1	468942.5297	4446521.729
2	468963.0914	4446572.23
3	468960.6688	4446616.347
4	468970.7355	4446647.15
5	468973.2363	4446679.835
6	468958.8713	4446697.475
7	469008.7593	4446742.921
8	469009.1362	4446777.156
9	469102.5489	4446817.181
10	469154.4195	4446826.839
11	469178.7008	4446803.299
12	469179.2401	4446761.348
13	469196.4178	4446736.911
14	469196.2559	4446697.123
15	469167.4566	4446657.451
16	469132.487	4446613.794
17	469100.2955	4446613
18	469091.4617	4446594.221
19	469055.5901	4446561.673
20	469033.9112	4446527.215
21	469003.9737	4446498.961
22	468975.2977	4446489.825
23	469269.514	4446786.274
24	469350.0852	4446811.548
25	469409.1514	4446786.325
26	469450.9485	4446763.023
27	469492.1382	4446706.412
28	469519.3711	4446651.399
29	469566.6698	4446642.264
30	469610.5587	4446609.084
31	469595.212	4446559.486
32	469578.3622	4446548.141
33	469571.6359	4446464.58
34	469555.3904	4446427.015
35	469455.3418	4446444.074
36	469421.5626	4446460.558
37	469407.0864	4446392.451
38	469342.9513	4446335.648
39	469311.6216	4446314.184
40	469212.3235	4446341.422
41	469171.7194	4446367.496
42	469135.6454	4446401.572
43	469137.706	4446442.586
44	469149.6984	4446481.401
45	469190.5465	4446515.472
46	469216.282	4446558.241
47	469240.5734	4446595.156
48	469266.9245	4446614.789
49	469294.6179	4446615.294
50	469309.1951	4446649.78
51	469291.9955	4446668.974
52	469290.0231	4446707.846
53	469295.365	4446741.136
54	469311.6539	4446314.142
55	469342.8701	4446335.599
56	469407.1546	4446392.573
57	469421.5808	4446460.464
58	469455.4045	4446444.185
59	469555.4133	4446426.932
60	469571.6916	4446464.558
61	469578.3199	4446547.898
62	469595.3779	4446559.205
63	469610.7789	4446609.015
64	469566.8179	4446642.254
65	469519.3478	4446651.319
66	469492.0549	4446706.392
67	469450.9207	4446762.927
68	469409.1041	4446786.419
69	469350.2295	4446811.469
70	469269.3256	4446785.931
71	469266.7913	4446796.361
72	469266.9862	4446805.913
73	469267.3761	4446820.34
74	469272.3473	4446839.055
75	469274.5892	4446843.051
76	469281.8024	4446857.38
77	469281.0226	4446869.174
78	469277.611	4446874.146
79	469270.7877	4446878.629
80	469258.7009	4446876.29
81	469251.7802	4446872.878
82	469230.6282	4446851.434
83	469218.5414	4446834.668
84	469208.2091	4446820.242
85	469191.8334	4446809.91
86	469179.3566	4446802.697
87	469154.7931	4446826.675
88	469102.7417	4446817.123
89	469009.3611	4446777.158
90	469008.7762	4446742.847
91	468958.8693	4446697.229
92	468973.2955	4446680.074
93	468970.5662	4446647.127
94	468961.0137	4446616.52
95	468963.1581	4446572.072
96	468942.6885	4446521.775
97	468975.245	4446489.609
98	469004.0974	4446499.161
99	468996.8843	4446489.609
100	468976.8046	4446474.598
101	468932.1612	4446493.313
102	468899.0199	4446526.649
103	468915.9805	4446552.187
104	468926.1178	4446602.679
105	468925.338	4446652.391
106	468917.1502	4446690.601
107	468952.4359	4446701.323
108	468983.2379	4446740.703
109	468986.552	4446754.739
110	468982.848	4446777.158
111	469000.7833	4446784.566
112	469033.5347	4446811.859
113	469082.8569	4446838.957
114	469150.6991	4446872.099
115	469253.0474	4446917.327
116	469329.8573	4446901.146
117	469391.8511	4446810.3
118	469445.657	4446786.321
119	469493.8094	4446736.414
120	469531.8245	4446672.471
121	469568.28	4446656.875
122	469623.6455	4446613.791
123	469635.5374	4446557.256
124	469635.7324	4446499.941
125	469737.6907	4446468.164
126	469787.4027	4446479.471
127	469798.1249	4446449.839
128	469817.035	4446442.626
129	469800.6592	4446403.636
130	469790.9118	4446367.376
131	469764.0088	4446305.772
132	469774.1462	4446261.908
133	469780.5795	4446187.827
134	469804.9481	4446156.441
135	469753.774	4446061.89
136	469633.198	4445928.448
137	469602.3961	4445940.924
138	469495.564	4445857.681
139	469375.6703	4445765.665
140	469279.3655	4445813.623
141	469173.7031	4445903.104
142	469183.4506	4445907.978
143	469189.1041	4445916.361
144	469207.8192	4445897.256
145	469239.3522	4445930.397
146	469265.8653	4445901.545
147	469265.3779	4445920.893
148	469270.4466	4445913.827
149	469272.591	4445899.888
150	469273.7607	4445897.987
151	469279.2193	4445896.086
152	469288.5281	4445895.94
153	469302.1258	4445898.816
154	469305.8298	4445898.474
155	469309.4851	4445894.478
156	469312.5068	4445910.902
157	469314.3589	4445922.599
158	469312.6043	4445931.469
159	469314.0664	4445936.636
160	469320.6947	4445942.192
161	469330.2472	4445953.499
162	469323.0341	4445969.192
163	469300.5175	4446010.131
164	469300.7124	4446018.904
165	469299.3478	4446024.655
166	469299.5427	4446030.796
167	469303.5392	4446034.5
168	469302.6619	4446057.114
169	469296.8134	4446069.688
170	469297.4958	4446089.086
171	469294.7665	4446110.14
172	469292.7195	4446114.234
173	469293.0119	4446119.498
174	469294.9614	4446123.689
175	469298.6655	4446131.975
176	469295.6437	4446152.444
177	469293.0119	4446157.708
178	469292.9145	4446182.174
179	469290.4776	4446189.874
180	469283.362	4446201.864
181	469280.0478	4446206.543
182	469277.0261	4446211.319
183	469298.568	4446232.081
184	469307.6331	4446235.493
185	469317.5755	4446237.832
186	469325.3735	4446238.417
187	469327.4204	4446243.29
188	469349.2547	4446248.749
189	469344.9659	4446251.088
190	469339.8972	4446251.673
191	469330.3447	4446261.226
192	469327.2255	4446261.421
193	469324.1063	4446272.435
194	469340.9694	4446281.403
195	469328.9557	4446307.063
196	469311.6639	4446314.142
197	469311.7514	4446314.081
198	469328.9069	4446307.063
199	469340.9938	4446281.33
200	469324.2281	4446272.362
201	469327.3473	4446261.445
202	469330.4665	4446261.25
203	469339.8241	4446251.698
204	469344.8927	4446251.113
205	469349.1816	4446248.773
206	469327.3473	4446243.315
207	469325.3978	4446238.441
208	469317.5999	4446237.856
209	469307.8524	4446235.517
210	469298.6898	4446232.008
211	469277.0505	4446211.343
212	469279.9747	4446206.664
213	469283.4838	4446201.986
214	469290.307	4446189.898
215	469292.8413	4446182.491
216	469293.2312	4446157.927
217	469295.7656	4446152.469
218	469298.8848	4446142.916
219	469298.6898	4446131.999
220	469294.9858	4446124.006
221	469292.8413	4446119.717
222	469292.8413	4446114.259
223	469294.7988	4446110.36
224	469297.5201	4446089.11
225	469296.7403	4446069.81
226	469302.7838	4446057.138
227	469303.3686	4446034.524
228	469299.6646	4446030.82
229	469299.2747	4446024.777
230	469300.6393	4446018.928
231	469300.6393	4446010.158
232	469323.0585	4445969.216
233	469330.0766	4445953.621
234	469320.7191	4445942.314
235	469314.0988	4445936.66
236	469312.5312	4445931.591
237	469314.2857	4445922.624
238	469312.5312	4445910.927
239	469309.412	4445894.551
240	469305.9029	4445898.45
241	469302.1989	4445898.84
242	469288.5525	4445895.916
243	469279.1949	4445896.111
244	469273.7363	4445898.06
245	469272.5666	4445900.01
246	469270.4222	4445913.851
247	469265.3535	4445920.868
248	469265.9384	4445901.569
249	469239.4253	4445930.422
250	469207.5811	4445897.378
251	469189.2259	4445916.288
252	469183.1825	4445908.1
253	469173.2401	4445903.226
254	469179.9171	4445917.116
255	469169.2437	4445955.521
256	469234.3586	4446048.317
257	469223.0294	4446066.642
258	469168.7563	4446061.379
259	469134.5427	4446108.166
260	469129.2791	4446180.493
261	469131.6185	4446252.429
262	469109.9791	4446303.31
263	469080.9317	4446359.846
264	469086.3903	4446416.381
265	469105.1054	4446467.847
266	469088.3398	4446490.267
267	468997.2986	4446489.682
268	469004.3168	4446499.039
269	469033.949	4446527.307
270	469055.9783	4446562.008
271	469090.8741	4446594.174
272	469100.8165	4446613.084
273	469132.7882	4446613.474
274	469167.6841	4446656.948
275	469196.9264	4446686.913
276	469196.1466	4446737.072
277	469179.381	4446761.246
278	469178.4063	4446802.77
279	469191.6628	4446810.178
280	469208.2335	4446820.12
281	469218.5658	4446834.742
282	469230.4577	4446851.312
283	469251.9021	4446872.757
284	469258.9202	4446876.461
285	469270.6172	4446878.41
286	469277.6353	4446873.926
287	469281.1444	4446869.247
288	469281.7293	4446857.551
289	469274.7111	4446843.319
290	469272.1768	4446839.03
291	469267.303	4446820.12
292	469266.9131	4446806.084
293	469266.9131	4446796.531
294	469269.4475	4446786.004
295	469295.3757	4446740.776
296	469289.7222	4446707.44
297	469291.6717	4446668.45
298	469308.4373	4446649.93
299	469294.4009	4446614.839
300	469267.2056	4446614.839
301	469240.995	4446594.954
302	469216.1289	4446558.206
303	469190.7855	4446515.123
304	469149.8462	4446481.396
305	469137.7594	4446442.407
306	469135.6149	4446401.862
307	469172.0704	4446366.961
308	469212.2299	4446341.033
309	469311.7514	4446314.881